MIXHAIT POLLOZHANI
МИЏАИТ ПОЛОЖАНИ

D R A U D A C U M

(NJËZET VJET ART)

D R A U D A C U M

(ДВАЕСЕТ ГОДИНИ УМЕТНОСТ)

Gostivar, 2019
Гостивар, 2019

Monografi: DRAUDACUM
(NJËZET VJET ART)

Autor: Mixhait Pollozhani

Përbotuesin: Reshat Ameti

Përkthimi: Elsa Pollozhani

Lektura: Agim Mustafai

Fotografitë: Arjan Rufati, Xhezair Rexhepi

Disenji: Arjan Rufati

Shtypi: “Evropa 92” - Koçan

Tirazhi: 100

Моногрaфија: DRAUDACUM
(ДВАЕСЕТ ГОДИНИ УМЕТНОСТ)

Автор: Мицаит Положани

За издавачот: Решат Амети

Превод: Елса Положани

Лектура: Агим Мустафаи

Фотографии: Арјан Руфати, Џезаир Реџепи

Дизајн: Арјан Руфати

Печат: „Европа 92“ – Кочани

Тираж: 100

PËRMBAJTJA

HYRJE **8**

HISTORIKU DHE FUNKSIONIMI I SHOQATËS "DRAUDACUM" **11**

Pse emri "DRAUDACUM"? 11

Qëllimi i krijimit të shoqatës 11

Themelimi dhe konsolidimi 14

Aktivitete e para ekspozuese 16

EKSPOZITAT - VEPRIMTARIA BARTËSE E SHOQATËS **18**

"Çmimi i Nëntorit" aktivitet mbarëkombëtar 19

Ekspozitat grupore me karakter humanitar dhe dedikues 24

"Salloni Pranveror" një aktivitetjetëshkurtër por domethënës 26

Ekspozitat individuale 27

Kolonia artistike ndërkombëtare "Gostivari" 30

Çmimet tradicionale 32

PARALELET STILISTIKE **33**

PËRFUNDIME DHE KONSTATIME **38**

LISTA E EKSPOZITAVE **78**

REPRODUKSIONE **87**

СОДРЖИНА

ВОВЕД **42**

ИСТОРИЈА И ФУНКЦИИРАЕ НА ЗДРУЕНИЕТО „ДРАУДАКУМ“ **45**

Зошто името „DRAUDACUM“? 45

Целта на формирање на здружението 45

Основањето и консолидација 49

Првите изложбени активности 50

ИЗЛОЖБИТЕ – НОСЕЧКА АКТИВНОСТ НА ЗДРУЖЕНИЕТО **53**

„Ноемвриска награда“ - Сенационална активност 54

Групните ликовни изложби од хуманитарен и наменски карактер 59

„Пролетен салон“ една прекината активност 61

Индивидуални изложби 62

Меѓународна ликовна колонија „Гостивар“ 65

Традиционални награди 67

СТИЛИЛСКИ ПАРАЛЕЛИ **69**

ЗАКЛУЧОЦИ И КОНСТАТЦИИ **75**

СПИСОК НА ИЗЛОЖБИ **82**

РЕПРОДУКЦИИ **87**

SHOQATA “DRAUDACUM” SIMBOL ARTISTIK

Me publikimin e kësaj monografie shënohet 20 vjetori i themelimit dhe i veprimtarisë por edhe arkivohet veprimtaria e Shoqatës së artistëve figurativ shqiptar në Maqedoni ***“Draudacum”*** me seli në Gostivar. Kjo shoqatëparaqet me të vërtetë një shembull të veçantë në këto hapësira kulturore. Me një angazhim të palodhshëm të anëtarëve të shoqatës, të kryesive, si dhe me ndihmën e institucioneve shtetërore dhe kulturore në vend dhe dashamirëve të artit, gjatë dy dekadave shoqata u transformua në një institucion të mirëfilltë vullnetare të artit pamor. Me veprimtarinë e vet përgjatë dy dekadave, ka zhvilluar dhe kultivuar në mënyrë sistematike artin pamor. Gjithashtu, kjo vatër artistike gëzon renome të jashtëzakonshëm në hapësirat kulturore dhe trajtohet si një ndër shoqatat më aktive dhe më të fuqishme të artit pamor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Por edhe më gjerë.

Gjithsesi, që rrugëtimi i derikëtushëm nuk ka qenë edhe gjithaq i lehtë, sepse, përveç problemeve objektive (mungesës së hapësirave: zyrave, depos etj,) ka hasur edhe me probleme subjektive, që burojnë nga smira njerëzore, të cilat herë – herë edhe e kanë frenuar zhvillimin e shoqatës! Por, duke i falënderuar entuziazmit të anëtarësisë më të gjerë, ndihmesës së adhuruesve të artit, artistëve, shoqata “Draudacum” i mbijeton këto anomali por edhe vazhdon akoma më fuqishëm aktivitetin e saj në prezantimin e vlerave të mirëfillta artistike. Shoqata “Draudacum” tani më është bërë simbol i identifikues i artit pamor shqiptar.

Sa i përket angazhimit tim si kryetar i shoqatës (dy mandate) bashkë me ekipin që për mua përbënë një “Dream team” (Ekip i ëndrrave) jemi kujdesur qe fillimisht shoqata të ketë një trajtim të pranueshëminstitucional, pastaj siguruam zyrën dhe depon dhe natyrisht, ndërkombëtarizuam fuqishëm veprimtarin ë shoqatës. Këtë e kemi dëshmuar me organizimin e intensifikuar të ekspozitave tradicionale, kolonive artistike me karakter ndërkombëtar, ekspozitave humanitare, ekspozitave individuale etj. Këto aktivitete padyshim që kanë lënë gjurmë, por njëherësh përbëjnë edhe një traditë të shkëlqyer në prezantimin e vlerave të artit pamor. Në aktivitetet e shoqatës vazhdimisht janë të pranishme veprat e artistëve nga

mbarë hapësirat kulturore shqiptare, si: Maqedonia e Veriut, Kosova, Shqipëria, si dhe nga diaspora. Kemi arrit që nëpër aktivitetete shoqatës të defilojnë artistë të dëshmuar, veteranë të artit pamor, artistë me relevancë artistike vendore dhe botërore. Por, gjithashtu, një kujdes të veçantë shoqata kemi treguar në promovimin e artistëve të rinj, artistë që për herë të parë e fillojnë rrugëtimin e tyre në botën e artit.

Besoj se shoqata “Draudacum” do të vazhdojëedhe më tutje misionin e saj fisnik në zhvillimin dhe afirmimin e artit dhe kulturës shqiptare. Do të vazhdoje të rritet në bastion ku do të mbështetën artistët shqiptarë dhe të tjerë, vatër ku do të kultivohet dhe promovohen vlerat e artit pamor. Por, gjithashtu, shoqata jonë do të vazhdojë të aderoi akoma më fuqishëm edhe në botën globale artistike, dhe sigurisht se do të organizojë edhe shumë ngjarje artistike e kulturore, si dhe do festojë edhe shumë e shumë përvjetorë tjerë.

Reshat Ameti
Kryetari SHAFM “Draudacum”

HYRJE

Shoqatat, apo grupet e artistëve figurativ, përbëjnë një fenomen shumë i rëndësishëm dhe shumë domethënës, të cilat në skenën e artit u paraqitën që me fillimin e avangardës së parë, aty kah gjysma e dytë e shekullit XIX, dhe duke marrë hovë sidomos gjatë epokës së artit (post)modern në shekullin XX. Ndaj dhe qëndron konstatimi se shoqatat, apo grupet e artistëve figurativ janë produkt i kohës së tyre, dhe si të tilla ato e ndajnë fatin e mjedisit ku veprojnë. Ndonëse ato herë-herë edhe e marrin kuptimin e ambientit të kulturës së vogël, por reflektimi i tyre në planin artistik është i konsiderueshëm. Që të zbërthehet rëndësia ethemelimit dhe funksionimit të grupeve të këtilla artistike, do të thotë se, duhet të kujtojmë kontekstin historik të veprimit të tyre. Shikuar nga ky këndvështrimdel, del që grupet dikur kanë pasur rrol tjetër në skenën artistike për dalim nga grupet e sotshme.

Grupet artistike pra, janë pjesë e rëndësishme dhe lëvizje të fuqishme shtytëse e zhvillimit të artit figurativ në rrafsh kombëtar dhe ndërkombëtar. Shikuar nga konteksti historik, dallohen dy kategori të strukturës së organizimit të këtyre shoqatave artistike. Strukturat e organizimit formal dhe joformal të shoqatave, të cilat janë paraqitur në momente të (pa)përshtatshme politike. Ata i kanë realizuar qëllimet e tyre në mënyra të ndryshme. Aktivitet e tyre nuk i përjashtojnë as supozimet teorike dhe as ato ideologjike. Ato mund të kenë qenë, por edhe mund të jenë paralajmëruese, nxitëse, dhe ndërtuese të proceseve të reja në fushën e artit figurativ.

Kjo parantezë pra, mund të merret si një perceptim nga këndvështrimi më i gjerë i rolit, veprimit dhe kontributit të shoqatave në fushën e artit figurativ, nëpërmjet të cilës do të arrimë deri te qëllimi kryesor i kësaj monografie. Dhe qëllimi ynë është pikërisht shpalosja e aktivitetit të një shoqate të artistëve figurativ, e cila tash e njëzet vite kultivon art. Dhe kjo është Shoqata e artistëve figurativ në Maqedoni “DRAUDACUM” me seli në Gostivar. Duhet theksuar se kjo shoqatë, në gjirin e saj, në radhë të parë tubon krijuesit figurativ shqiptar, por jo vetëm këta, sepse në të ka edhe artist të tjerë. Kuptohet se shoqata “DRAUDACUM” lindi në një kontekst kohor, kur shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, fare pak ishin të angazhuar por edhe të përfshirë në mënyrë të mirëfilltë në sferën e artit figurativ në vend.

Dhe kur më propozoi idenë për të shkruar tekstin për një publikim monografik për këtë shoqatë, kryetari aktual i saj, artisti dhe profesori i pikturës në Universitetin e Tetovës, Reshat Ameti, fillimisht mu duk pak sa pretencioz ky projekt. Jo pse më mungonin informacionet bazike mbi aktivitetin e saj, pasi që vite me radhë e kam përcjellë punën e saj, por kur u përballa me materialet e ruajtura në arkivin e shoqatës, atëherë e pash më prej së afërmi, sesa i gjerë dhe sa i rëndësishëm është aktiviteti i saj në planin artistik.

Ndonëse, tanimë kur kanë kaluar më shumë se një shekull që nga krijimi i shoqatave të njohura artistike nëpër shtet e ndryshme të Evropës, por edhe në shtet fqinje, mund të duket anakronike veprimi i shoqatave të këtilla, megjithatë, ato kanë rëndësinë e tyre edhe sot kur arti figurativ ka pësuar një transformim të madh. Dhe sipër koincidencë, kur ne e shënojmë njëzet vjetorin e shoqatës “DRAUDACUM”, sivjet po e shënon njëqindvjetorin e saj edhe shkolla e njohur e arkitekturës dhe dizajnit “Bauhaus” e cila u themelua në vitin 1919 në qytetin Vajmar të Gjermanisë. Ky mbase është një ogur i mirë jo vetëm për shoqatën tonë por edhe për artin figurativ shqiptarë.

Ashtu siç e kërkon rendi, me raste të këtilla, kur është fjala për përvjetorë jubilar, domosdo që bëhet rekapitullimi i punës dhe i veprimtarisë së shoqatës në fjalë. Dhe tani kur kemi grumbulluar rezultatet me bindje konstatojmë se, “Draudacum” ka një rol të rëndësishëm në organizmin dhe mbarëvajtjen e jetës së artit figurativ te shqiptarët të Maqedonisë së Veriut. Por jo vetëm, sepse veprimtaria e saj shtrihet akoma më gjerë dhe se brenda tij përfshinë edhe prurjet e arrtit në rrafshin mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare.

Para se gjithash kjo ka të bëjë me veprimtarinë ekspozuese me të cilat janë afirmuar me dhjeta e me qindra krijues, duke përcjellë zhvillimin e tyre, fillimin, ngritjen apo rënien në art. Para se gjithash, si shkak kryesor për këtë mund të merret vetë karakteri revyal dhe masovik i ekspozitave të organizuara, të cilat herë kanë ndikuar për të mirë dhe herë edhe i ka komplikuar punë. Themi kështu sepse disa krijues të njohur jo rrallë ka ndodhur që t’i shmangen pjesëmarrjes nëpër aktivitet e këtilla prezantues.

Megjithatë, shoqata “Draudacum” duke u rritur në një ngrehinë alternative artistike i ka tubuar dhe i ka orientuar pesën dërmuese të atyre energjive dhe ideve artistike drejt zhvillimit të mëtutjeshëm me aktivitetin e saj. Bërthamën substanciale të aktiviteteve ekspozuese dhe të llojshmërisë së disiplinave artistike figurative të përfshira në te e përbëjnë: piktura, skulptura, vizatimi, grafika, por nuk janë anashkaluar as edhe fotografia, artet e zbatuara (dizajni) dhe shumë rrallë ndonjë ekzemplar i instalimeve artistike.

Mbarëvajtja e punës së shoqatës “Draudacum”mund të thuhet se ka kaluar nëpër disa periudha kohore, të cilat herë kanë qenë më intensive dhe herë më të zbehta. Vitet fillestare, më shumë kanë kaluar me punët formale, se sa me aktivitete artistike, por kuptohet nuk mungon as edhe ndonjë ekspozitë, ashtu që, duke filluar që nga viti 2005, kjo shoqatë përjetoi një ringjallje të vërtetë të aktivitetit të saj. Në ndërkohë që veprimtaria gjatë dekadës së dytë shquhet për një mobilizim të përgjithshëm, konsolidim dhe zgjerim akoma më gjithëpërfshirës të shoqatës. Dhe atë, jo vetëm në veprimtarinë ekspozuese, por akoma më shumë kjo vërehet edhe nëpërmjetorganizimit të kolonisë artistike dhe të ndonjë aktiviteti tjetër. Për çdo vit vërehet rritja e numrit të pjesëmarrësve nëpër këto aktivitete, sidomos të atyre nga jashtë, me çka hapet një dimension i ri i rolit të kësaj shoqate në kultivimin e vlerave artistike në rrafsh më të gjerë mbarëkombëtarë. Por për të qenë korrekt me lexuesin, do të duhet të pranuar se kjo është një shoqatë joqeveritare, vullnetare e cila përballet me vështirësitë të ndryshme, në radhë të parë të karakterit financiar, por pse jo edhe të atij organizativ. Sidomos duhet theksuarse, kësaj shoqate i mungon një qasje më e qartë dhe më e programuar formale dhe përmbajtjesore në drejtim të kaheve zhvillimore të artit bashkëkohor figurativ shqiptar.

Por ashtu siç u tha edhe me lartë, se ky publikim monografik, pra ofron informacione për kontributin e kësaj shoqate nëndodhitë dhe botëkuptimet të cilat shfaqen në skenën e artit tonë figurativ sidomos gjatë dy dekadave të para të shekullit XXI. Por gjithashtu kjo paraqet edhe një përpjekje për grumbullimin në një vend të gjitha aktiviteteve, artistëve dhe krijimtarisë artistiketë krijuar gjatë këtyre viteve. Por në të do të përfshihet edhe puna dhe kontributi i ideatorëve, ndërtuesve dhe ndihmuesve të projektit të quajtur “DRAUDACUM”.

HISTORIKU DHE FUNKSIONIMI I SHOQATËS “DRAUDACUM”

Ashtu siç u cek në tekstin hyrës, se shoqatat e këtilla janë produkt i kohës së caktuar, gjithashtu duhetnënvizuarse, krijimi dhe funksionimi i tyre varet nga kontekste të caktuar historik dhe socio-politik. Të shqyrtosh dhe pasqyrosh qëllimin e krijimit dhe kontributin e një shoqate artistike, pra edhe të “Draudacumit”, domosdo që duhet vënë në pah kontekstin historik dhe socio-kulturor, komponentë këta vendimtare përzhvillimin e artit figurativ shqiptar në Maqedoninë e Veriut, por edhe më gjerë.

Pse emri “DRAUDACUM”?

Zakonisht shoqatat artistike marrin emra që kanë të bëjnë me fushën e artit, ose që lidhen me natyrën, qëllimin, simbolikën apo edhe misionin e ekzistimit të tyre. Rasti i emërtimit të kësaj shoqate është ndryshe, pasi që themeluesit e saj deshën që me këtë emër të përligjin dy momente të rëndësishme. Së pari të ringjallin një topitmi të lashtë ilir, siç është Draudacum, i cili sipas autorëve antik mendohet të ketë qenë emri i një qyteti antik në rrethin e Gostivarit (mendohet se gjurmët e tij mund të fshihen te fshati Gradec?), por kjo akoma nuk është dëshmuar nga arkeologët. Dhe së dyti, ky emër do të shërbej si inspirim, por edhe si obligim për kultivimin, përjetësimin dhe ruajtjen e vlerave artistike si trashëgimi artistike nëpërmjet veprimtarisë së kësaj shoqate.

Qëllimi i krijimit të shoqatës

Shoqatat e këtilla artistike, pra, si produkt i kohës së tyre, padyshim që edhe endajnë fatin mjedisit të tyre, dhe se duke u projektuar si të tilla, ato domosdo që e marrin kuptimin e një ambienti të kulturës së vogël, jo rrallë herë janë të detyruara që të përballen me tendencat margjinale artistike. Por duke e shikuar fotografinë e gjerë të saj, atëherë dukshëm mbisundon bindja se, megjithatë kontributi i kësaj shoqate e arsyeton qëllimin e këtij publikimi. Kujtesa e

atij momenti të themelimit të krijon emocione, ndjenja nostalgjie të përcjella edhe me elemente mistifikuese, pse jo edhe glorifikuese. Por, para se gjithash, gjatë shkrimit të kësaj monografie, përparësi do tu japim aspiratave për një objektivitet racional dhe të arsyeshëm, ashtu siç e kërkon edhe natyra e disiplinës shkencore historiko – artistike. Ne vetëm mund të supozojmë se si mund të jenë ndier dhe çfarë aspironin protagonistët, në atë momente tejet domethënë të krijimit të kësaj shoqate.

Kjo shoqatë lindi në kohën kur arti bashkëkohor ishte shënjuar nga ndryshimet të shpeshta stilesh dhe me avancimin dhe zgjerimin e mundësive teknike në fushën e artit figurativ. Shoqatë brenda saj ka një përbërje heterogjene për kah struktura e gjinive artistike, pse jo edhe për kah përkatësia etnike e nacionale që kanë kontribuuar për aktivitetin e saj. Por, ky grup krahas intencave tjera inkurajoi një qëllim të vazhdueshëm, që të pushtohen dhe të forcohen pozitat e artit modern dhe atij bashkëkohor me të gjitha tendencat avangarde dhe neoavangarde.

Kjo shoqatë u krijua jashtë institucioneve, ashtu siç i zhvillua në një farë mënyre edhe vetë arti figurativ shqiptar në Maqedoninë e Veriut, por, për prezantimin e veprimtarisë së saj, megjithatë, ajo i shfrytëzon hapësirat e muzeve dhe galerive shtetërore. Qëllimet dhe detyrat e saj kjo shoqatë i ka përmbledhur kryesisht në kuadër të përmbajtjes të një dokumenti formal, por pa ndonjë program të definuar qartë, apo manifesti të lidhur ngushtë me kërkime artistike dhe ideore (konceptuale) të anëtarëve të saj. Megjithatë, shoqata “Draudacum” u bë faktor shumë aktiv dhe tejeti rëndësishëm i zhvillimeve të artit figurativ shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Ndërkohë që përqendrimi i energjisë krijuese, por edhe i asaj hulumtuese dhe eksperimentuese të artistëve, sidomos me ndihmën e kësaj shoqate, u bënë forca shtytëse për artin figurativ të nënqiellit tonë.

Me proceset demokratike që nisën në fillim të viteve 90 – ta të shekullit të kaluar u hap rruga për demokratizimin e shoqërisë edhe në Maqedoninë e Veriut (atëherë Republika e Maqedonisë. Shqiptarët filluan të (vet)organizohen në të gjitha sferat e jetës, në aspekt politik, arsimore, kulturor etj. Pas shumë përpjekjesh të pareshtura dhe vështirësive të mëdha, përveç partive politike, shqiptarët themeluan edhe organizata të ndryshmejoqeveritare, të cilat funksionojnë si shoqata, bashkësi apo asociacione të ndryshme në fushën e arsimit dhe

kulturës. Kështu si nevojë e imediate dhe e drejtë e mohuar nga autoritetet e kohës në vitin 1994 u themelua Universiteti i Tetovës, i cili pas plotë dhjetë vitesh qëndrese dhe peripecisharriti të zyrtarizohet në vitin 2004. Por themelimi i këtij institucioni më të lartë arsimor hapi shumë perspektiva të reja për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut. Sidomos, hapja e Fakultetit të arteve dha impulse të fuqishme për krijuesit figurativ shqiptarë. Kështu, mbase, lindi ideja dhe nevoja edhe për themelimin e shoqatës “Draudacum”.

Sigurisht që në ndërkohë janë themeluar edhe shoqata tjera nga fusha e artit figurativ, disa nga të cilët akoma pa u themeluar u shuan, por ka nga ato që e vazhduan aktivitetin e tyre dhe sot e kësaj dite vazhdojnë të veprojnë aktivisht. Ndër ato duhet përmendur Shoqatën e artistëve figurativ në Tetovë, SHAK “A-3” në Strugë etj. Por megjithatë, shoqata “Draudacum” jo vetëm që mbijetoi, ajo edhe u veçua dhe u dëshmuame aktivitetin e saj të vazhdueshëm dhe tejet të pasur me evenimente të ndryshme. Kjo shoqatë, tash më ka krijuar identitetin e saj duke u bërë një emër i respektuar, jo vetëm brenda kufijve të Maqedonisë së Veriut, por edhe më gjerë, në planin mbarëkombëtar dhe në atë ndërkombëtar. Për këtë flasin edhe mirënjohjet e ndryshme që janë ndarë kësaj shoqate për aktivitetin e sajderi më tani.

Dhe pikërisht sivjet, kur shoqata “Draudacum” po e shënon 20 vjetorin e themelimit të saj, në këtë jubile, mbase jo gjithaq i gjatë, por me të arritura të shumta në veprimtarinë e saj. Dhe me të drejtë mund të thuhet se, mjaft bukur i shkon motoja “DRAUDACUM” – 20 VJET ART”, e cila njëherë përbënë edhe titullin e kësaj monografie. Por, ky sukses, që sot e ka arrit shoqata “Draudacum” i ka protagonistët dhe më të merituarit e tij, ndaj dhe nuk bënë pa i përmendur disa ngaata me emër dhe mbiemër, të cilët ndonëse, punuan dhepunojnë në mënyrë vullnetare, megjithatë, asnjëherë nuk u shmangën obligimeve tëshoqatës. “*Të gjitha këto synime i arritëm bashkërisht me anëtarësinë, me ekipin drejtues të shoqatës dhe me institucionet vendore. Ndaj dhe e shfrytëzoj rastin që personalisht tu falënderohem: anëtarësisë, artistëve, si dhe në veçanti ekipit tim “Dream team” (Ekip i ëndrrave) i përbërë nga Xhelil Rufati, Ismane Mehdi, Arjan Rufati, Xhezair Rexhepi, Ylber Zylfiqari, Bejtulla Zaimi, Muamer Sadiku, Muhamedali Alili – Dali, Luan Zenku, Berkan Hasanicaj*, e nisi rrëfimin e tij, kryetari aktual i shoqatës “Draudacum”, profesori universitar, Reshat Ameti.

Por sigurisht që ka edhe shumë të tjerë që meritojnë vend në këtë monografi. Duhet të veçohen ata që informuan për aktivitetet e shoqatës, siç janë gazetaret, Blerim Mustafai, Arben Zeqiri, Driton Zenku, Valbona Zynçe, Bashkim Sulejmani, Abedin Bilalli, Hatixhe Muaremi, Gzime Imeri si dhe mediat TV Globi, Tv 2, Tv Koha, Tv ALSAT dhe Gazeta Koha, Klan Maqedonia, RM2 si dhe përkthyesin Agim Mustafain, por veçanërisht, ata të cilët shkruan vështrime dhe kritika mbi krijimtarinë që ka defiluar gjatë dy dekadave të kaluara të funksionimit të "Draudacum". "*Kuptohet që për rezultatet e shoqatës "Draudacum" ka më shumë njerëz që kanë ndihmuar, por unë do ta veçoja njërin ndër ta, dhe ai është ish-kryetari i komunës së Gostivarit, z. Nevzat Bejta, i cili përderisa ishte në post, në vazhdimësi i ka ndihmuar fuqishëm aktivitetet e shoqatës. "Mos na kurseni, vetëm artistët të ndihen sa më mirë thoshte Ai". Dhe po të shikosh grafikun e zhvillimit të shoqatës, duket qartë se pikërisht në kohën e tij shoqata u konsolidua plotësisht, si dhe veprimtaria e saj artistike mori hov edhe në planin ndërkombëtar*", theksoi kryetari Reshat Ameti

Themelimi dhe konsolidimi

Ndonëse krijuesit dhe artdashësit gostivaras e mbajtën barrë kryesore, megjithatë, jehona e kësaj shoqate kalon përtej kufijve lokal. Një grup entuziastësh, kryesisht artist figurativ, por edhe intelektual të fushave tjera, nga Gostivari, Tetova, Shkupi, Kumanova, Struga, Kërçova, Dibra etj., duke e ndier nevojën për të vepruar të organizuar mbështetën dhe ndihmuan krijimin e kësaj shoqatë, pa e ditur se ajo do të bëhej strehë e tyre artistike. Por sigurisht ashtu si shumëçka që e ka një nismë dhe bartësit e saj, edhe shoqata "Draudacum" e ka zanafillën dhe i ka protagonistët më të merituar për krijimin e saj.

Kështu pas një aktiviteti paraprak një grup më i vogël intelektualësh përgatiti terrenin, dhe më datë 25. 12. 1999 e themeluan Shoqatën e Artistëve Figurativ në Maqedoni "DRAUDACUM" me seli në Gostivar. Në Kuvendin themelues u miratua programi, statuti dhe u zgjodhën organet drejtuese të shoqatës. Kryetar i parë i shoqatës u zgjodh piktori, Bashkim Mexhiti, aktualisht profesor në Fakultetin e Arteve pranë Universitetit të Tetovës. Gjithashtu,

duhet të theksohet se lista e themeluesve të kësaj shoqate është më e gjerë, pa mbështetjen e të cilëve nuk do të ishte i mundur themelimi dhe ndërtimi i saj. Për këtë flet edhe lista me nënshkrimet e tyre që po e sjellim si ilustrim nëformë faksimili.

Idenë dhe iniciativën e themelimit të kësaj shoqate, njëri nga themeluesit kryesor, njëherësh edhe kryetari parë i saj, Bashkim Mexhiti, e shpjegon me mungesën dhe nevojën e institucioneve kulturore shqiptare asokohe në Maqedoni e Veriut.. Krijimin e saj, Mexhiti e shikon si një mundësi për hapjen e perspektivave të reja mbi zhvillimin dhe pasurimin e fushës së arteve pamore të shqiptarëve brenda Maqedonisë së Veriut. "*Entuziazmi dhe përkushtimi ynë për këtë iniciativë fuqishëm u përkrah edhe nga ana e artistëve të komunave tjera si edhe nga një grup i dalluar intelektualësh të qytetit të Gostivarit, disa nga të cilët ishin pjesëmarrës edhe në kuvendin e themelimit të shoqatës mbajtur para njëzet vitesh ne sallën e kuvendit komunal të Gostivarit*" shprehet, Bashkim Mexhiti. Por, Mexhiti vëndoi në pah edhe kontributin të pakursyer të kolegëve artistë: Rami Muharemi, Agim Shehu, profesori universitar Xhelil Rufati drejtori i SHF. "Mehmet Deralla" të f. Gradec. Hetem Ademi, dashamiri i artit Bekim Keçai, por edhe disa intelektualë tjerë të qytetit, në jetësimin e idesë dhe krijimin e shoqatë "Draudacum".

Ndërkaq, nënkryetari i parë i shoqatës "Draudacum" ka qenë piktori, Luan Zenku, i cili sipas pohimeve të stafit drejtues të shoqatës, që nga fillimi dhe deri më sot është pjesë e pandarë pothuajse e të gjitha aktiviteteve të saj duke dhënë një kontribut të çmuar në veprimtarinë dhe konsolidimin e kësaj shoqate. Gjithashtu, për tu theksuar është kontributi i pamohueshëm i anëtarësisë, por sidomos edhe menaxhimi i suksesshëm nga ana e kryetarëve që vijnë më pas, siç janë: Burhan Ahmeti, Osman Demiri dhe Reshat Ameti. Puna e palodhshme e tyre, e mbështetur nga Ministria e Kulturës së Maqedonisë së Veriut dhe nga Komua e Gostivarit ndikuan që Shoqata e Artistëve Figurativ "Draudacum", të dëshmoi potencial, të shënoi rezultate dhe të instaloi vlera të larta në prezantimin e artit pamorë që vazhdon të hapëron me kohën si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Aktivitete e para ekspozuese

Sigurisht që fillimet e shoqatës “Draudacum” nuk kanë qenë të lehta. Viti i parë i veprimit (vitit 2000) ka kaluar në shenjë të themelimit, konsolidimit të organeve dhe trupave drejtuese, si dhe të regjistrimit të saj. Sipas dokumentacionit mund të konstatohet se Shoqata e Artistëve Figurativ Shqiptar në Maqedoni “Draudacum” është regjistruar zyrtarisht me një vit vonesë, dhe atë, me datë 25. 12. 2000.

Kuvendisolemn i themelimit të Shoqatës së Artisteve Figurativ “Draudacum,, është promovuar me hapjen e ekspozitës së pare të saj, të cilën e hap kryetari i porsazgjedhur, Bashkim Mexhiti. Për këtë ekspozite si dëshmi ekziston edhe një fletëpalosje ku kumtohet organizimi i saj, dhe se aty janë të publikuar edhe emrat e 27 artistëve që morën pjesë në këtë aktivitet historik. Në këtë fletëpalosje figurojnë këto artist: Adem Kastrati, Meli Zenku, Hajrush Fazliu, Faik Kryeziu, Bedri Saraçini, Sabit Bocku, Nafi Jashari, Bashkim Mexhiti, Luan Zenku, Qamil Sejfuli, Enver Selimi, Bukurie Saliu, Nevzat Bejtuli - Kica, Safet Spahiu, Muamer Sadiku, Emine Asani, Ilirjan Beqiri, Ismet Lahu, Hajrush Hiseni, Afërdita Ramizi, Reshat Ameti, Rami Muharemi, Bleranda Borova, Melik Asllani, Beqir Beqiri, Fuat Jakupi dhe Agron Zemruli. “*Rrugëtimi i pare katërvjeçarë (2000-2004) për shoqatën ka qene një rrugëtim i mbushur me shumë kujtime dhe përjetime, të gjitha aktivitetet e realizuara gjatë asaj periudhe e sidomos ekspozita mbarëkombëtare 28 Nëntori, organizuar çdo vit nga ana e shoqatës “Draudacum,, kanë qenë të mbështetura dhe financuara vetëm nga komuna e Gostivarit, me në krye kryetarin e atëhershëm Xhemail Rexhepi*”, përfundon, Bashkim Mexhiti.

Ekzistojnë shoqata të ndryshme në të cilat aderojnë krijues të tëgjitha moshave, por qëllimin e arsyetojnë vetëm ato shoqata të cilat për njëmend i mbrojnë interesat e artistëve që e avancojnë dhe e promovojnëpunën e tyre. Aq më tepër, kur dihet se një shoqatë e arsyeton misionin e saj, nëse ka vendosur, si dhe ka zbatuar kritere në avancimin e vlerave të mirëfillta artistike dhe kulturore. Këto janë parimet mbi të cilën e ka bazuar programin dhe aktivitetin e saj edhe shoqata “Draudacum”.

Por menjëherë në vitin e ardhshëm, përkatësisht në vitin 2002, ripërtërihet organizmi i ekspozitës me karakter gjithëkombëtar, e cila sivjet e shënoi edicionin e saj të 18 - të me radhë. Dhe që nga ajo ekspozitë organizatori është përkujdesur që të botoi edhe katalogë për çdo aktivitet prezantues me parathënie të shkruar nga studiues, kritik të artit dhe artist të njohur të artit shqiptar.

Dhe kështu nisi funksionimin dhe aktivitetin shoqata “Draudacum”, e cila për dy dekada me radhë pati baticat dhe zbaticat, ngritjet dhe rëniet e saj. Për njëzet vite rresht kjo shoqatë ka organizuar aktivitet të shumta në fushën e artit figurativ duke dëshmuar se ajo jo rastësisht tani më është bërë bartëse e jetës artistike të shqiptarëve ngavendi dhe më gjerë. Aktivitetet kryesore të saj janë përqendruar në organizimin e ekspozitave grupore dhe individuale, kolonive artistike, realizmin e projekteve artistike, shënimin e përvjetorëve të ndryshme kombëtare, konkurseve etj. Dhe për më të suksesshmit në planin artistik, organizativ por edhe për ata që nuk janë kursyer për ta ndihmuar aktivitetin e saj, shoqata për çdo vit ndan edhe çmime apo mirënjohje.

Nëpër aktivitetet e shoqatës “Draudacum” kanë parakaluar shumë artistë, emra të njohur dhe kulmor nga vendi dhe nga bota. Artistë të dëshmuar por edhe të rinj të cilët janë shpresa dhe ardhmëria e skenës sonë artistike. Pro nuk bënë pa i përmendur sidomos emrat e artistëve të spikatur nga vendet fqinje, shteteve evropiane dhe kontinenteve tjerë.

EKSPOZITAT - VEPRIMTARIA BARTËSE E SHOQATËS

Duhet rikujtohet edhe njëherëfakti se aktivitetet e para të promovimit të shoqatës “Draudacum” filluan menjëherë pas themelimit të saj, fillimisht duke filluar me një ekspozitë në të cilën kanë marrë pjesë artistë nga viset e ndryshme shqiptare. Veprimtaria e viteve në vijim të shoqatës vjen duke u pasuruare dhe me më shumë aktivitete të ndryshme artistike, ku përveç ekspozitave, kolonive artistike, u shtohen edhepunëtoritëartistike apo edhe prezantime me karakter humanitaretj. Projektet e këtilla shtytëse u mundësojnë dhe i ndihmojnë artistët që të zënë hapin dhe ritmin e trendëve më bashkëkohore të arteve pamore. Dhe kështu, organizimi i ekspozitave vlen si aktiviteti bartës i tërë veprimtarisë së shoqatës, të cilat u bënë manifestime shumë kuptimplote duke prezantuar dhe promovuar vlera artistike dhe emra artistësh të dëshmuar dhe sidomos të artistëve të rinj, të cilët luajnë, apo do të marrin rol të rëndësishëm në skenën e artit bashkëkohor shqiptar.

Pra, në mënyrë të vazhdueshme janë organizuar aktivitete të ndryshme prezantuese, dhe se sipas evidencave dhe dëshmive të ndryshme, mund të shihet se në kuadër të aktivitetit të kësaj shoqate dominon organizimi i ekspozitave grupore, duke filluar nga ekspozita tradicionale revyale mbarëkombëtare dhe deri tek ato me dedikime të caktuara. Kur jemi tek aktivitetet prezantuese grupore, padyshim që një vend të posaçëm dhe rol të rëndësishëm luan ekspozita e cila organizohet me rastin e 28 Nëntorit - Festës së Flamurit Shqiptar, e cila për vite me radhë mbahet nën moton “Çmimi i Nëntorit”. Për disa vite me radhë është organizuar edhe aktiviteti tjetër prezantues i quajtur “Salloni pranveror”, si dhe disa ekspozita tjera me dedikim të caktuar profesional, kulturor, humanitar dhe përkujtimor. Duhet theksuar se disa nga këto ekspozita kanë edhe karakter shëtitës.

“Çmimi i Nëntorit” aktivitet mbarëkombëtar

Por megjithatë, tradita më e bukur dhe më jetëgjate e kësaj shoqate padyshim që mbetet ekspozita mbarëkombëtar e cila pati një rritë të përbashkët me të. Ky aktivitet tani më është kthyer në një eveniment, ku në një vend për çdo vit tubohen krijues të artit figurativ nga gjitha trojet shqiptare. Ndonëse, kjo ekspozitë fillimisht organizohej nën moto të ndryshme, për të cilat do të bëhet fjalë në vazhdim, organizatori ka menduar se mjaft mirë i shkon këtij aktiviteti mbarëkombëtar emërtimi “Çmimi i Nëntorit” nëpërmjet të cilit reflektohet në formën e plotë tërësia dhe karakteri tij.

Ndaj dhe shikuar nga kjo distancë kohore, mund të thuhet se nuk është punë e vogël që një manifestim kulturor të mbijetojë në rrethanat e sotshme shoqërore, aq më tepër kur bëhet fjalë për një aktivitet nga fusha e artit figurativ, veprimtari kjo e cila nuk shquhet për ndonjë traditë gjithaq të gjatë ndër shqiptarët këtu në Maqedoninë e Veriut. Por, megjithatë, shoqata “Draudacum” i ka sfiduar tërë ato barriera dhe vështirës, dhe nga viti në vit po ia del, jo vetëm të mbajë gjallë ekspozitën “Çmimi i Nëntorit”, por edhe ta begatoi, por deri diku edhe ta profilizoi atë.

Ashtu siç u tha edhe më lartë, kjo ekspozitë ka rrëfimin e rritës së saj, duke u begatuar dhe transformuar për vite me radhë, megjithatë, një gjë e ka ruajtur të shenjtë, dedikimin dhe çeljen e saj me rastin 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit. Nëse ekspozita e parë e kaloi në shenjë të aktit themelues dhe të promovimit të Shoqatës “Draudacum”, ekspozita e radhës pati një tjetër motiv dhe dedikim. Dhe pikërisht, ekspozita e dytë e hapur në vitin 2002 konsiston me shënimin e 90 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, motoja e së cilës ishte “**Pavarësi, Flamur, Liri**”. Kjo ekspozitë ka tubuar artist figurativ shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria. “*Mesazhet që na i përcjellin këto vepra nuk janë klithje të ashpra dhe të zymta të shkaktuara në moment nga trysnia politike, por thjesht përjetime normale të shprehura secila me gjuhën e vet artistike të qëlluar, ku më pa e ku më shumë*”, thuhet në parathënien e katalogut.

Ndërkaq, karakterin e mirëfilltë mbarëkombëtar ky eveniment akoma më shumë e merr në vitin 2003, kur në këtë eveniment veprat e tyre i kanë prezantuar jo më pak se 48 artist nga

mbarë trojet shqiptare. Këtë e dëshmon edhe lista e pjesëmarrëseve të në faqet e katalogut të kësaj ekspozite dhe ato janë: Esat Valla, Eshref Qahili, Meli Zenku, Bashkim Mexhiti, Luan Zenku, Sindis Ibraimi, Rami Muharemi, Reshat Ameti, Osman Demiri, Ilirjan Beqiri, Safet Spahiu, Muamedali Alili, Bajram Xhelili, Burhan Ahmeit, Fatmir Krypa, Bajram Kadria, Besnik Xhemaili, Adem Dermaku, Bukurie Saliu, Nevzat Bejtuli – Kica, Blerim Iseini – BIRD, Hajrush Fazliu, Memet Selmani, Imer Bajrami, Melik Arsllani, Meliha Kabashi, Alpaj Rexhep, Agim Shehu, Faton Kryeziu, Klodian Valla, Fatmire Beshiri, Hajrush Iseni, Vlora Ismaili, Agim Rudi, Nafi Jashri, Ilir Koka, Genti Korini, Zenun Sherifi, Edip Lloga, Emin Elezi, Bleta Mirzo, Bejtulla Zaimi, Xhelil Rufati, Beqir Qerimi, Nebije Berisha, Muamer Sadiku, Ismet Jonuzi dhe Zeni Ballazhi. "*Kompozicionet e ekspozuar shquhen për një shumësi frymëzimesh e preokupimesh...., të cilat simbolizojnë një dozë të shprehjes realiste, ekspresioniste, simboliste, enformeliste, si dhe me frymën e gjerë të abstraksionit*" ka thënë Hiviz Muharremi.

Me kalimin e viteve kjo ekspozitë jo vetëm që e ruajti vazhdimësinë e saj, por ajo akoma më shumë begatohej dhe merrte fizionomi të re. Kjo u manifestua gjatë dy viteve në vijim, në vitin 2004 dhe 2005, kur kjo ekspozitë vazhdoi ta përforcojë akoma më shumë karakterin e saj mbarëkombëtar. Duke qenë se kjo ekspozitë tuboi artistë nga të gjitha viset shqiptare, filozofi dhe esteti Kadri Metaj ka theksuar: "*Dhe pikërisht ajo që dominon në këtë ekspozitë të aranzhuar mirë është simbolika, funksionimi artistik i shumë shtresave simbolike i të qenit bashkë në një ekspozitë nga Tirana, Shkupi, Prishtina, Tetova, Gostivari dhe disa gjenerata, rreth një teme bosht që është memorie historike, akt shtetformues, veprim civilizues dhe premtim komunikues që thyen barrierat, kufijtë, paragjykimet*".

Në këtë frymë kalon edhe ekspozita e katërt e vitit 2005 e cila bëhetnjëra nga ngjarjet më tërëndësishme artistike dhe kulturore në rrafshin gjithëkombëtar. Duhet përkujtuar se, që nga ky vit, kjo ekspozitë filloi të ndaj edhe çmimin fitues të saj. Në ndërkohë që gjatë dy viteve të ardhshme ekspozita bëhet pjesë e përcjellëse e manifestimit me karakter shtetëror, i cili i dedikohej kulturës shqiptare. Ashtu që, në vitin 2006 ekspozita mbarëkombëtare organizohet në kuadër të "*Javës të kulturës shqiptare në Maqedoni*" në bashkëpunim me Galerinë Nacionale "Çifte Hamam" në Shkup. Krijuesi dhe kritiku i artit, Mustafa Ferizi, në lidhje me këtë ekspozitë

është shprehur: "*Vetë koncepti i kësaj ekspozite flet së është fjala për prononcim artistik të përbashkët të krijuesve shqiptar që veprojnë në Maqedoni, Shqipëri e Kosovë, por edhe të atyre që vinë nga trevat tjera të qenësisë sonë kombëtare, duke përfshirë edhe diasporën*". Ndërkaq edhe në vitin 2007 ky eveniment vazhdon të mbetet pjesë përbërëse e manifestimit të riemërtuar "*Ditët e kulturës shqiptare*" të organizuar në bashkëpunim me Galerinë Nacionale "Çifte Hamam" në Shkup dhe me Qendrën për kulturë në Gostivar.

Që ky aktivitet tradicional i Shoqatës "Draudacum" të marr karakterin akoma më të theksuar garues, duke filluar që nga viti 2008, dhe për të vazhduar edhe deri më sot, kojë ekspozitë është riemërtuar "Çmimi i Nëntorit". Kjo ka motivuar artistët dhe se eka rrit akoma më shumë nivelin artistik të saj. Për këtë flet edhe fakti se në ekspozitën e këtij viti kanë marr pjesë gjithsej 62 artistë figurativ shqiptar nga Maqedonia, Kosova, Shqipëria dhe Diaspora. Një pjesëmarrje kaq e madhe po dëshmon se ky eveniment po kthehej në një "arenë" për dëshmimin e artistëve shqiptar, por edhe një formëkomunikimi dhe bashkëbisedimi të komunitetit artistik, si dhe një mundësi për njohjen e publikut me misionin e artit. "*Por edhe për ta edukuar me shije artistike, me tema shoqërore, me frymëzim tolerance bashkëbiseduese ndër komunitet e një vendi multietnik*", është shprehur mes tjerash studiuesja dhe kuratorja e artit, Suzana Varvarica - Kuka. Edhe gjatë dy viteve në vijim, më 2009 dhe 2010, ky aktivitet artistik vazhdon të mbetet në frymën e karakterit për të cilin organizohet por edhe në nivelin e qëllimit të përcaktuar programor nga ana e shoqatës "Draudacum". Në këto dy ekspozita akoma më e shprehur është fryma tradicionale artistike ku duket hapur se në pikturë, skulpturë, grafik etj dominon figuracioni.

Në dekadën e dytë të saj, Shoqata "Draudacum" futet akoma më e kompletuar dhe më e gjithanshme, si në aspektin organizativ, ashtu edhe në planin artistik, duke e begatuar aktivitetin e saj edhe me ekspozita tjera kolektive dhe ngjarjetë ndryshme artistike. "*Ekspozitat kolektive e reflektojnë zhvillimet dhe tendencat e kohës dhe hapësirës konkrete në të cilat gravitojnë artistët*", ka nisur tekstin e katalogut të ekspozitës së vitit 2011, kryetari i atëhershëm i shoqatës "Draudacum", Osman Demiri. Ekspozita e radhës "Çmimi i Nëntorit" 2012 ndërkaq, si shumë aktivitete dhe manifestime tjera në rrafshin mbarëkombëtar, u bë pjesë e shënimit

të organizuar të përvjetorit jubilar të njëqind vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar nën moton "**100 Vjet Pavarësi**". Me këtë ndërmarrje artistike shoqata "Draudacum" edhe njëherë dëshmoi se mundi "*tu përballoi sfidave të kohës, ndodhive historike, politike, kulturore, sociale etj*", ka konstatuar ndër tjera Reshat Ameti në fjalën e ti për katalogun kësaj ekspozite.

Por, përqendrimi kryesor i organizatorit padyshim që vazhdon të fokusohej tek ekspozita mbarëkombëtare. Evenimenti "Çmimi i Nëntorit", apo siç parapëlqen ta quaj kryetari aktual i shoqatës, Reshat Ameti, "salloni i nëntorit", tani më ka marrë jehonë akoma më shumë ndër krijuesit shqiptar. Duke qenë se ky aktivitet është etabluar në mënyrë të plotë në skenën e artit kombëtar shqiptar dukshëm ka ngritur shkallën e nivelit artistik të saj. Organizatori ka mprehur kriteret e pjesëmarrjes në te dhe në një farë mënyre edhe e ka përforcuar edhe karakterin garues të këtij evenimenti. Duket qartë se ky aktivitet në mënyrë kronologjike prezanton dhe regjistron një pjesë të krijimtarisë kombëtare artistike duke paraqitur aktualitetet dhe preokupimet e artit pamor shqiptar. "*Interesimi kaq i madh i artistëve nga të gjitha trevat shqiptare për të marrë pjesë në këtë ekspozitë, dëshmon se kjo shoqatë është kthyer në një epiqendër të artit shqiptar, fortesë e ku kultivohet dhe zhvillohet arti pamor, shkëlqim i vlerave të dëshmuara dhe mundësi për artistët e rinj...*". është shprehur Reshat Ameti me rastin e hapjes së ekspozitës "Çmimi i Nëntorit" 2014.

Ndërkaq, ekspozita e vitit 2015 edhe njëherë dëshmoi për masivitetin e saj dhe interesin e artistëve të shumtë për tu prezantuar në këtë ngjarje të rëndësishme për artin shqiptar. Vlen të theksohet se në këtë ekspozitë kanë marrë pjesë gjithsej 42 krijuese nga mbarë trojet shqiptare, dhe ata janë: Agim Rudi, Agron Abduli, Ajser Shabani – Khasrovi, Arbenita Kryeziu, Armend Ademi, Arjan Rufati, Bejtulla Zaimi, Burim Ukiçi, Dita Starova-Qerimi, Fehmi Hoxha, Fitore Fejzullai, Flamur Miftari, Florina Aziri – Murati, Genc Bekteshi, Hanife Islami, Hilmi Memeti, Imer Barami, Leoneta Abdyli, Luan Zenku, Lulzime Osmani, Marijana Goxhabelliu, Meli Zenku, Melik Arsllani, Muhamedali Alili – Dali, Muamer Sadiku, Muhamet Ameti – Metis, Muhamet Veseli, Nagip Ismaili – Nagi, Nafi Jashari, Nebush Ajeti, Osman Demiri, Refki Gollopeni, Reshat Ameti, Reshat Amiti, Rezelinda Begaj, Safet Spahiu, Sajmir Ameti, Serhat Emrullai, Shkurta Haxhiu, Shqipe Mehmedi, Xhezair Rexhepi, Xhelil Rufati, Zarije Amdiu dhe

Zenun Sherifi. Ndërkaq, Lulzim Haziri, duke e cilësuar përmbajtjen e këtij evenimenti si veçori të konkurrimit për çmim ai i ka potencuar heterogjeninë e kësaj ekspozite. "*Hasim zhanre të ndryshme: pikturë, skulpturë, grafikë dhe fotografi, gjejmë përmes artistëve që prezantohen për herë të parë përkrah artistëve që tash më kanë bërë emër si dhe dallimet në teknika, motive, forma etj*" shprehet Haziri.

Në tekstin e katalogut të ekspozitës së vitit 2018, autori Reshat Ameti vë në pah veprat e një numri të konsiderueshëm të artistëve të cilët marrin pjesë për herë të parë në këtë manifestim prezantues, dhe se me bashkëpjesëmarrësit tjerë me veprat e tyre sjellin ide dhe filozofi të re estetike. Duke filluar që nga gjuha stilistike dhe deri te mesazhet artistike, që nga realja, asociativja dhe deri tek abstraksioni dhe zgjedhjet e ndryshme konceptuale ka thënë ndër të tjera Reshat Ameti. Gjithashtu duhet cekur se në katalogun e kësaj ekspozite organizatori ka publikuar edhe emrat e fituesve të "Çmimit të Nëntorit" si dhe fituesit për pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, fotografi, art konceptual, duke filluar që nga viti 2006 e deri në vitin 2017.

Pra nga kjo që u tha, rezulton që në këtë eveniment kanë parakaluar me qindra artistë dhe vepra artistike, të cilët i kanë vënë vulën e manifestimit me karakter mbarëkombëtarë të këtij aktiviteti të përvitshëm artistik. Në ambientet e salloneve ekspozuese të këtij manifestimi kanë parakaluar edhe emrat artistëve më të njohur shqiptarë, të cilët përcaktuan koordinatat e vlerave ideo – estetike të shpalosura për vite me radhë në këtë dhe shumë ekspozita tjera. Një temë në vet mbetet vlera ideo-estetike dhe gërshetimi stilistik i prurjeve artistike të kësaj ekspozite.

Ekspozita tradicionale "Çmimi i Nëntorit" vazhdon edhe më tej të mbetet njëri ndër manifestimet më cilësor të organizuara në trevat tona kulturore. Pra, ekspozita "Çmimi i Nëntorit", është më shumë sesa një çmim! Ky pra është inspirimi, dëshmimi dhe shtytja drejt konsolidimit dhe të afirmimit të artit dhe krijuesveshqiptar.

Ekspozitat grupore me karakter humanitar dhe dedikues

Për tu veçuar janë ekspozitat grupore të cilat Shoqata "Draudacum" i ka organizuar kohë pas kohe, ku kryesisht fjala është për aktivitete me karakter dedikues. Këto ekspozita, të begatuara me vepra të krijuesve të ndryshëm shqiptar, por edhe të tjerë, kryesisht lidhen me ngjarje historike, personalitet të shquara apo edhe ndodhi të parashikuara.

Një atmosferë bashkëpunimi sapo kishte filluar të reflektohet në nënqiellin ballkanik në fushën e arteve pamore, për të dëshmuar se artistët më mirë se të gjithë të tjerët po i tejkalojnë barrierat, cilat do qofshin ato. Një dëshmi të këtillë përbënedhe ekspozita e një grupi artistësh nga vendet të ndryshme që u hapë në Bullgari. Kjo ekspozitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të SHAFM "Draudacum" me seli në Gostivar (Maqedoni) dhe të Galerisë "Lessedra" nga Sofja (Bullgari). Dhjetë krijues që vijnë nga vise të ndryshme: Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova nëpërmjet punimeve të tyre, por me ndihmën e "Draudacum" kanë shpalosur aspekte nga krijimtaria e atëhershme të kësaj pjese ballkanike.

Pikërisht, gërshetime gjinish dhe teknikash të ndryshme pamore, buqete realizimesh ideo – estetike, materializojnë koncepcione të ndryshme filozofike. Krijimet e prezantuara nëpërmjet formash dhe figuracionesh të gjeometrizuara, shprehjeve abstrakte të rikompozuara, foto-pamjeve, sjellin sekuenca që deshifrojnë fatume të përbashkëta njerëzish dhe qytetërimesh. Sigurisht që këto provokacione artistike sfidohen dhe plotnohen mjeshtërisht nga autorët e veprave, të cilët, duket se janë përzgjedhës të mirë, jo vetëm idesh dhe motivesh, por edhe të vendosur drejt vokacioneve individuale artistike.

Ndërkaq, gjatë vitit të dytëtë veprimit të kësaj shoqate, meqenëse ishtekoha kur plasi lufta e viti 2001, u pamundësua ndonjë aktivitet më i theksuar artistik i saj. Pro kur jemi këtu vlen të përmendet ekspozita humanitare me moton "***Humaniteti i artistëve në vepër***" që u organizua farepak kohë; pas përfundimit të luftës së vitit 2001, hapja e të cilës u bë më 22 tetor, në Art klubin, "Alternativa". "*Shoqata e Artisteve Figurativ Shqiptarë në Maqedoni "Draudacum" me veprat e tyre artistike ata e ngrenë zërin e vetëdijes shpirtërore*

individuale, por edhe frymën e vetëdijes kolektive kombëtare kundër çdo forme të dhunës dhe solidarizohen me të gjithë atë që është humanitare, fisnike, kombëtare por edhe gjithë-njerëzore... ", është shprehur gazetari A. Zeqiri në gazetën FAKTI, më 2 nëntor / viti IV nr. 1072 / 2001 shkruan:

Shoqata "Draudacum" një ekspozitë të rëndësishme, po ashtu me karakter humanitar, e ka organizuar në bashkëpunim me Organizatën "El Hilall" nën moton "*Humaniteti artistik në vepër...*". Kjo ekspozitë është hapur në Qendrën për kulturë të qytetit të Kumanovës për ti ndihmuar familjet e dëmtuara nga Kumanova gjatë përleshjes së grupit të armatosur shqiptar me forcat policore të Republikës së Maqedonisë së Veriut që ndodhi në muajin maj të vitit 2015. Kjo ekspozitë është prezantuar edhe nëpër disa qytete tjera të vendit, siç janë: Gostivari, Shkupi dheDibra.

